



Jeta ime

Description

Bart Ehrman

Marrë nga libri i Bart Ehrman-it; 'Misquoting Jesus': The Story Behind who Change the Bible and Why; Harper Collins Publishers; New York 2005

Kam lindur dhe jam rritur në një vend e kohë shumë konservatore, në qendrën e kombit, në fillim të mesit të viteve 50. Në edukimin tim nuk pati asgjë të jashtzakonshme. Ne ishim një familje tipike prej pesë personash që frekuentonim kishën, por pa qenë tej mase fetarë. Në kohën kur unë hyra në klasë të pestë, ne ishim pjesë e kishës peshkopale në Lorens, Kansas, një kishë me një famullitar të urtë, i cili ishte edhe fqinj me ne dhe djalit e tij e kisha një nga shokët mi të ngushtë (me të cilin u zura më vonë në shkollë të mesme pas një mosmarrëveshjeje për një punë duhani e purosh). Si shumë kisha të tjera peshkopale, edhe kjo jona ishte e respektuar dhe e përgjegjshme nga ana shoqërore. Në të liturgjia konsiderohej e rëndësishme dhe shkrimi i shenjtë ishte pjesë e kësaj liturgjie, por Bibla nuk mbitheksohej shumë. Ajo ruhej si një udhëzues për besimin dhe praktikën, së bashku me traditën e kishës dhe moralin e përbashkët. Ne zakonisht nuk flisnim shumë rreth saj e as e lexonim shpesh atë, qoftë edhe në shkollën e së dielës, e cila përqendrohej më shumë në çështjet praktike dhe shoqërore, si dhe në mënyrën se si duhej jetuar në këtë botë.

Bibla zinte një vend nderi në shtëpinë tonë, veçanërisht për nënën time, e cila herë pas here lexonte pjesë prej saj dhe tregonte kujdes që ne të kuptonim historitë dhe mësimet etike që ajo përmbante (e më pak ato "doktrinë"). Deri në vitet e mia të gjimnazit, kam përshtypjen se e kam parë Biblën si një libër të mistershëm, por me rëndësi për fenë. E megjithatë, nuk e shihja atë si diçka, në të cilën duhej të thellohesha. Ajo më përçonte një ndjesi lashtësie dhe ishte e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me Zotin, Kishën dhe adhurimin. Në atë kohë, ende nuk shihja ndonjë arsye për ta lexuar apo studiuar atë.

Gjërat ndryshuan në mënyrë rrënjësore për mua kur unë isha nxënës i vitit të dytë në gjimnaz. Pikërisht atëherë përjetova një përvojë prej "të rilinduri" ("born again"), në një kontekst krejt të

ndryshëm nga ai i kishës ku isha rritur. Unë isha një “fëmijë i zakonshëm”; një nxënës i mirë, i interesuar dhe pjesëmarrës në sporte të ndryshme që zhvilloheshin në shkollë, por nuk shkëlqoja në asnjë prej tyre; i interesuar dhe aktiv në jetën shoqërore, por jo në skalionin e parë të elitës më popullore të shkollës. Mbaj mend që ndieja një zbrazëti të brendshme që dukej se asgjë nuk mund ta mbushte; as dalja me shokët (në atë kohë kishim nisur të pinim së bashkë gjatë veprimtarive festive), as takimet e dashurisë (sapo kisha filluar të bëhesha pjesë e *mysterium tremendum* të botës së seksit), as shkolla (unë mësoja shumë e merrja nota të mira, por nuk isha një superyll), as puna (isha shitës ambulant i një firme që tregtonte prodhime për të verbërit) e as kisha (isha një psaltës i mirë dhe pak a shumë i përkushtuar – duhej të ishe të dielave në mëngjes, pas gjithë asaj që ndodhte të shtunave në mbrëmje). Një lloj vetmie shoqërohej asokohe me të qenit adolishent, por, sigurisht, unë nuk e kuptoja atëherë se kjo ishte pjesë e moshës dhe isha i bindur se më mungonte diçka.

Kjo ishte koha kur fillova të merrja pjesë në takimet në kampin e Klubit të Rinisë për Krishtin (*Youth for Christ Club*). Ato zhvilloheshin në shtëpitë e të rinjve. Takimi i parë ku u paraqita zhvillohej në kopshtin e shtëpisë së një të riu që ishte shumë popullor asokohe mes shokëve të tij dhe kjo më bëri të mendoj se ai grup ishte i duhuri për mua. Kreu i atij grupi ishte një djalë rreth të njëzetave, i quajtur Brus, i cili zhvillonte takime të Klubeve të Rinisë për Krishtin në nivel lokal dhe përpiquej të kthente nëxënësit e gjimnazit në të krishterë “të rilindur” e më pas t’i përfshinte ato në studimet biblike, në takimet e adhurimit e në veprimtari të tjera të ngjashme. Brusi kishte një personalitet shumë tërheqës. Ishte më i ri se prindërit tanë, por gjithsesi më i madh dhe më me përvojë se ne, me një mesazh të fuqishëm, sipas së cilit zbrazëti që ne ndienim brenda nesh (*ne ishin adolishentë!* Të gjithë ndienim një zbrazëti!) vinte për shkak se nuk e kishim pranuar Krishtin në zemrat tona. Nëse ne do të kërkonim që Krishti të hynte në zemrat tona, ai do ta bënte këtë dhe do ta mbushte zemrën tonë me një gëzim e lumturi të tillë që vetëm të “shpëtuarit” mund ta kuptonin.

Brusi mund ta citonte Biblën sipas dëshirës dhe e bënte këtë në një mënyrë të mahnitshme. Duke pasur parasysh respektin, por edhe paditurinë time për Biblën, gjithçka që ai thoshte më dukej bindëse. E kjo ishte shumë e ndryshme nga përvojat e mia në kishën e mëparshme, e cila zbatonte rituale të vjetra e dukej më e pështatshme për të rriturit sesa për të rinj që ishin të prirur drejt qejfit dhe aventurës, por që ndienin një zbrazëti brenda tyre.

Për t’i rënë shkurt, unë njoha Brusin dhe e pranova mesazhin e tij të shpëtimit, i kërkova Jezusit të hynte në zemrën time dhe përjetova një përvojë të mirëfilltë dhe të sigurtë prej të rilinduri. Në të vërtetë, unë kisha lindur pesëmbëdhjetë vjet më parë, por kjo ishte diçka krejt e re dhe ngazëlluese për mua. Ajo më futi në një rrugë të gjatë besimi, e cila, me kalimin e kohës, mori shumë kthesa të forta, duke përfunduar në një pikë të vdekur që, siç u pa më vonë, u shndërrua në një rrugë të re që unë e ndërmora këtu e tridhjetë vjet më parë.

Ata që, sikurse ne, kishin përjetuar këtë përvojë prej të rilinduri, e konsideronin veten si krishterë “të vërtetë”- ndryshe nga ata që shkonin në kishë vetëm për forcë zakoni, që nuk e kishin, në të vërtetë, Krishtin në zemrat e tyre e që, kështu, ecnin symbyllur jashtë çdo realiteti. Një nga mënyrat se si ne e veçonim veten nga të krishterët e tjerë ishte duke u zotuar seriozisht në leximin e Biblës dhe në ritualin e lutjes, sidomos në studimet biblike. Vetë Brusi ishte një njeri biblik. Ai kishte shkuar në “Moody Bible Institute” në Çikago dhe mund të citonte përgjigje nga Bibla për çdo çështje që ne mund të na vinte ndërmend (e për shumë të tjera që neve nuk na shkonte mendja). Shumë shpejt më lindi dëshira edhe mua që ta gëzoj këtë aftësi të tijën dhe fillova edhe vetë të merrem me studime biblike, duke mësuar shumë tekste, duke kuptuar rëndësinë e tyre, madje edhe duke mësuar përmendësh disa

pjesë kyçe.

Brusi më bindi që unë duhej të merrja në shqyrtim idenë që të bëhesha një i krishterë “serioz” dhe t’ia përkushtoja veten krejtësisht fesë së krishterë. Kjo nënkuptonte studimin e Biblës me kohë të plotë në “Moody Bible Institute”, i cili, mes të tjerash, përfshinte edhe një ndryshim rrënjësor të stilit të jetës. Në institut ekzistonte një “kod” etik që studentët duhej ta ndiqnin medoemos: pijet, duhani, vallëzimi, të luajturit me letra, filmat ishin të gjitha të ndaluara; sipas sloganit që ishim mësuar të thoshim: “Moody Bible Institute”, ku *Bibla* është në qendër të emrit tonë. Unë e shihja atë institut si një lloj kampi stërvitor për të krishterë. Sidoqoftë, kisha vendosur të mos ngurroja në fenë time, ndaj dhe bëra kërkesë për t’u pranuar në institut dhe shkova atje në fund të vitit 1973. Përvoja në institut ishte shumë e rëndë. Vendosa të diplomohem në teologjinë biblike, gjë që nënkuptonte marrjen përsipër të një numri të madh kurseesh të studimeve biblike dhe të teologjisë sistematike. Vetëm një këndvështrim shpjegohej në këto kurse, që duhej të pranohej e të nënshkruhej si nga të gjithë pedagogët (ata duhej të hidhnin firmën në një deklaratë), ashtu edhe nga studentët (edhe ne bëmë të njëjtën gjë): Bibla është fjala e pagabueshme e Perëndisë. Ajo nuk përmban asnjë gabim. Ajo është krejtësisht e frymëzuar në çdo fjalë të saj; frymëzim i plotë verbal. Të gjithë kurset që unë ndoqa parashikonin dhe mësonin këtë pikëpamje. Çdo këndvështrim tjetër shihej si i keqduhëzuar apo deri edhe heretik. Besoj se shumëkush mund ta quajë këtë lavazh truri, por për mua kjo ishte një “hap i madh përpara” prej asaj pikëpamjeje të druajtur që kisha pasur për Biblen gjatë rinisë sime të hershme si pjesëtar i Kishës Peshkopale. Ky ishte Krishterimi i rreptë për ata që i përkushtoheshin plotësisht.

Ishte e dukshme se kishte një problem në pohimin se Bibla ishte verbalisht e frymëzuar në çdo fjalë të saj. Siç mësuam në një nga kurset e para të ndjekura në institut, ne nuk i zotërojmë dorëshkrimet origjinale të Dhiatës së Re. Ajo që ne kemi janë kopje të këtyre shkrimeve, të bëra vite më vonë; në raste të shumta, shumë vite më vonë. Mbi të gjitha, asnjëra prej këtyre kopjeve nuk është krejtësisht e saktë, duke qenë se skribët që i kanë prodhuar ato, pa dashje ose qëllimisht, i kanë ndryshuar në vende të ndryshme. Të gjithë skribët e kanë bërë këtë. Kështu, në vend që të kemi fjalët e frymëzuara të autorëve (d.m.th. origjinalet) të Biblës, ajo çka kemi janë vetëm kopje të shkara në gabime të shumëfishimeve. Sidoqoftë, një nga detyrat më të rëndësishme ishte saktësimi i asaj që thuhet në origjinalet e Biblës, duke pasur parasysh, së pari, që ato janë të frymëzuara dhe së dyti, që ne nuk i zotërojmë ato.

Më duhet të pohoj se për shumë kolegë të institutit kjo çështje ishte e parëndësishme. Ata ishin të lumtur të strehoheshin pas pohimit se origjinalet e teksteve ishin të frymëzuar dhe përpjekshin, pak a shumë, t’i bishtnonin të vërtetës se ato nuk kanë mbijetuar deri në ditët tona. Ndërsa për mua ky ishte një problem i madh. Ai kishte të bënte drejtpërsëdrejti me fjalët që Perëndia kishte frymëzuar. Ne duhej të njihnim domosdoshmërisht se ç’fjalë kishte thënë Perëndia nëse dëshironim të dinim se si kishte komunikuar Ai me ne. Duke qenë se fjalët e tekstit origjinal ishin fjalët e Perëndisë, ekzistenca e disa fjalëve të tjera (ato që, në mënyrë të qëllimshme apo jo, ishin krijuar nga skribët) nuk na ndihmonin dhe aq shumë në përpjekjet tona për të njohur fjalët e vërteta që kishte thënë Perëndia.

Kjo ishte ajo që më bëri të interesohesha për dorëshkrimet e Dhiatës së Re që kur isha 18-vjeçar. Në institut, unë mësova bazat e shkencës së njohur si kritika tekstuale; një term teknik për të përshkruar shkencën që merret me rindërtimin e fjalëve “origjinale” të një teksti në rastet kur ato janë ndryshuar. Mirëpo ende nuk isha i përgatitur për të ndërmarrë një studim të mirëfilltë në këtë fushë. Në radhë të parë, më duhej të mësoja greqishten, gjuha origjinale e Dhiatës së Re, e ndoshta edhe disa gjuhë të tjera si hebraishten (gjuha e Dhiatës së Vjetër) dhe latinishten, për të mos përmendur

gjuhët moderne evropiane si gjermanishten dhe frëngjishten, për të parë se ç'kishin thënë teologët lidhur me këto çështje. Kisha një rrugë shumë të gjatë përpara.

Në fund të studimeve të mia trevjeçare në institut, dola me rezultate të mira dhe isha më shumë se kurrë i bindur se dëshiroja të bëhesha një teolog i krishterë. Mendimi im asokohe ishte se teologë të ditur ndërmjet të krishterëve ungjillorë kishte plot, por të atillë gjendeshin me vështirësi ndërmjet teologëve të mëdhenj shekullaristë, kështu që unë kisha vendosur të bëhesha një “zë” ungjillor në këto qarqe, duke marrë diploma dhe kryer specializime mes tyre, ndërkohë që do t'i mbetesha besnik bindjeve të mia ungjillore. Së pari, më duhej të përmbushja gradën “bachelor” dhe për ta bërë këtë më duhej të shkoja në kolegjin ungjillor më të mirë të asaj kohe. Për këtë zgjedha “Wheaton College”, që ndodhej në një periferi të Çikagos. Në institutin ku isha më paralajmëruan se do të kisha probleme për të gjetur në “Wheaton” të krishterë të vërtetë, gjë që tregon se sa fundamentalist ishte instituti që kisha kryer: kolegji “Wheaton” ishte i hapur vetëm për ungjillorë dhe, sa për shembull, ishte krenaria e Billy Grahamit. Në fillim, kolegji më dukej tepër liberal për shijet e mia. Studentët aty diskutonin për letërsinë, historinë e filozofinë më shumë sesa për frymëzimin e fjalëpërfjalshëm të Biblës. Natyrisht, ata i zhvillonin këto diskutime duke u nisur nga këndvështrimi i krishterë, por edhe nëse ishte kështu, a nuk kuptonin ata se këto gjëra ishin të parëndësishme?

Vendosa të diplomohem për letërsie angleze në “Wheaton”, duke qenë se leximi kishte qenë prej kohësh një prej pasioneve të mia, si dhe për faktin se për t'u integruar në qarqet e teologëve, duhej të specializohesha edhe në një tjetër disiplinë përveç disiplinave biblike. Vendosa, gjithashtu, që ti kushtohesha studimit të gjuhës greke. Gjatë semestrit tim të parë në “Wheaton”, u njoha me dr. Gerald Hawthorne-in, pedagogun tim të greqishtes dhe një njeri që ndikoi shumë në jetën time si teolog, mësues dhe mik. Hawthorne-i, si shumica e profesorëve të mi në “Wheaton”, ishte një besimtar i krishterë ungjillor, por ai nuk kishte frikë të ngrinte pikëpyetje rreth besimit të tij. Në atë kohë, unë e shihja këtë si një shenjë dobësie (në fakt, unë mendoja se kisha përgjigje pothuajse për çdo pyetje të ngritur prej tij); unë e shihja si një zotim real ndaj së vërtetës dhe si një dëshirë për të qenë i hapur ndaj çdo mundësie që pikëpamjet të rishikohen nën dritën e një dijeje dhe të një përvoje jetësore më të madhe.

Mësimi i greqishtes ishte një përvojë rrënjëthënëse për mua. Siç u pa më vonë, unë isha shumë i aftë në gjuhë dhe e kisha shumë të lehtë mësimin e tyre. Mirëpo në një nivel më të lartë, përvoja e mësimin të gjuhës greke u bë shumë shqetësuese për mua dhe për këndvështrimin tim për shkrimin e shenjtë. Unë arrita të njoh që në hapat e para se kuptimi dhe nuancat e tekstit grek mund të njiheshin plotësisht vetëm kur ai lexohej dhe studiohej në gjuhët origjinale (të njëjtën gjë mund të pohojmë edhe për Dhiatën e Vjetër, siç e kuptova më vonë kur mësova gjuhën hebraike). Një arsye më tepër, mendova unë, për të mësuar thellësisht gjuhët biblike. Në të njëjtën kohë, kjo më shtyu të pyes veten rreth konceptit tim për Biblën si libër të frymëzuar nga Zoti në mënyrë të fjalëpërfjalshme. Nëse kuptimi i plotë i fjalëve të Biblës mund të njihet plotësisht vetëm kur studiohet greqishtja (dhe hebraishtja), a nuk do të thotë kjo se shumica e të krishterëve, të cilët nuk i njohin gjuhët biblike, nuk kanë pasur asnjëherë njohje të plotë mbi atë që Perëndia ka dëshiruar që ata të njohin? A nuk e kthen kjo doktrinën e frymëzimit në një doktrinë vetëm për elitën që ka inteligjencën dhe kohën e nevojshme për të mësuar gjuhët dhe për të studiuar tekstin biblik në formën origjinale? Për çfarë vlen të mburremi se fjalët e Biblës janë të frymëzuara, kur shumica e njerëzve nuk i njohin këto fjalë, por kanë parë vetëm ca shndërrime të trasha të këtyre fjalëve në ndonjë gjuhë si anglishtja, e që nuk kanë të bëjnë aspak me fjalët origjinale? ¹

Pyetjet e mia u ndërlikuan më tej që kur unë fillova të mendoj gjithnjë e më shumë rreth dorëshkrimeve biblike dhe fjalëve që ato përcjellin. Sa më shumë e studioja greqishten, aq më shumë interesohesha për dorëshkrimet që kanë ruajtur tekstin e Dhiatës së Re për ne, si dhe për shkencën e kritikës tekstuale, e cila mendohet se mund të na ndihmojë për të rindërtuar fjalët origjinale të Dhiatës së Re. I kthehesha vazhdimisht pyetjes sime themelore: Si mund të na vijë ne në ndihmë shprehja se Bibla është fjala e pagabueshme e Perëndisë, nëse ne, në të vërtetë, nuk i zotërojmë fjalët e pagabueshme dhe të frymëzuara të Tij, por vetëm fjalët e kopjuara nga skribët, disa herë në mënyrë të saktë e disa herë (shumë herë!) në mënyrë të pasaktë? Ç'dobi ka të thuash se tekstet origjinale të Biblës janë të frymëzuara? Ne nuk i zotërojmë tekstet origjinalet, por kemi vetëm kopje të mbushura me gabime dhe shumica e këtyre dorëshkrimeve janë prodhuar shekuj më vonë se origjinalet.

Këto dyshime më mundonin shumë dhe më dërgonin të rrëmoja thellë e më thellë për të kuptuar se çfarë ishte Bibla në të vërtetë. Pasi i mbarova studimet e mia në "Wheaton" në dy vjet, vendosa, sipas udhëzimit të profesor Hawthorne-it, që t'i kushtohem shkencës së kritikës tekstuale të Dhiatës së Re dhe shkova të studioj me ekspertin më të madh në botë të kësaj fushe, Bruce M. Metzger, që jepte mësim në Seminarin Teologjik të Pristonit (Princeton Theological Seminary).

Sërish u paralajmërova nga miqtë e mi ungjillorë që të mos shkoja në Seminarin e Pristonit, meqenëse, siç më thanë ata, do të hasja shumë probleme për të gjetur ndonjë të krishterë "të vërtetë" atje. Në fund të fundit, ai ishte një seminar presbiterian, çka nuk përbënte ndonjë truall pjellor për të krishterë të rilindur. Por studimi i letërsisë angleze, i filozofisë dhe i historisë, për më mos përmendur greqishten, e kishin zgjeruar shumë horizontin tim dhe pasioni im tani ishte dija, dija e çdo lloji, e shenjtë apo shekullare. Nëse mësimi i "së vërtetës" nënkuptonte pamundësinë për t'u indentifikuar me të krishterët e rilindur, të cilët i kisha njohur në gjimnaz, atëherë kështu le të bëhej! Isha i vendosur ta ndiqja hap pas hapi dëshirën time për të vërtetën kudo që ajo do të më dërgonte, duke pasur besim se çdo e vërtetë që mësoja nuk bëhej më pak e vërtetë nga ç'ishte për shkak të vështirësisë që të hynte në kafazin e pëllumbave që kishte krijuar sfondi i besimit tim ungjillor.

Sapo mbërrita në Seminarin Teologjik të Pristonit, menjëherë u regjistrova në kursin e ekzegjzës (interpretimit) së hebraishtes dhe të greqishtes dhe e ngarkova programin sa kisha mundësi me këto lëndë. Vështirësia e këtyre kurseve ishte një sfidë për mua si nga ana akademike, ashtu edhe nga ana personale. Sfida akademike ishte e mirëpritur, por sfida personale ishte tejet e rëndë emocionalisht. Siç e kam thënë edhe më parë, që kur isha në "Wheaton", kisha nisur të vija në pikëpyetje disa prej aspekteve themelore të bindjes sime se Bibla ishte fjala e pagabueshme e Perëndisë. Kjo bindje u cënua seriozisht gjatë studimeve të mia të hollësishtme në Prinston. Unë i qëndrova çdo përpjekjeje për të ndryshuar mendim dhe u miqësova me disa njerëz që, njësoj si unë, vinin prej shkollave konservatore dhe po përpiqeshin të "ruanin besimin e tyre" (tani që shoh pas, kjo më ngjan një mënyrë komike të shprehuri, teksa ne, në fund të fundit, merrnim pjesë në një program të krishterë teologjie). Mirëpo studimet filluan pushtojnë e u dhashë i gjithi pas tyre.

Pika ime e kthesës ndodhi në semestrin e dytë, kur po ndiqja një kurs të drejtuar nga pedagogu i nderuar e i përkushtuar, profesor Cullen Story. Kursi ishte mbi ekzegjzën e Ungjillit të Markut, i cili në atë kohë (sikurse edhe sot) ishte ungjilli im i preferuar. Për të kryer këtë kurs, ishte e nevojshme që ne të ishim në gjendje të lexonim ungjillin e Markut krejtësisht në gjuhën greke (unë e mësova përmendësh krejt fjalorin grek të këtij ungjilli një javë para se të fillonte semestri). Ne duhej të mbanim një libër shënimesh ekzegjetike, ku të pasqyronim interpretimet tona për disa pjesë kyçe të Markut.

Pasi t'i diskutonim problemet e ndryshme të interpretimit të tekstit, në fund të kursit duhej të paraqisnim një ese lidhur me interpretimin e një pasazhi problematik, të cilin na ishte lënë e lirë ta zgjidhnim vetë. Unë zgjodha një pasazh që ndodhet tek kapitulli i dytë i Markut, ku rrëfëhet përballja e Jezusit me farisenjtë për shkak se dishepujt e tij kishin ecur përmes një are me grurë gjatë së shtunës dhe kishin këputur disa kallinj gruri. Jezusi dëshironte t'u tregonte farisenjve se “e shtuna është bërë për njeriun dhe jo njeriu për të shtunën” dhe u përkujtoi atyre se ç'kishte bërë mbreti David kur ai dhe njerëzit e tij ishin të uritur, si ata shkuan në Tempull “në kohën e kryepriiftit Abiathar” dhe hëngrën bukën e paraqitjes, që nuk i lejohej ta hante askush përveç priiftërinjve. Një nga problemet e njohura të këtij pasazhi është se, nëse i hedhim një vështrim pjesës së Dhiatës së Vjetër të cituar nga Jezusi (1 Samuel 21: 1-6), bëhet e qartë se Davidi e ka bërë këtë veprim kur kryepriift nuk ishte Abiathari, por babai i tij Ahimeleku. Me fjalë të tjera, ky është një nga ato pasazhe, të cilat shpesh janë shqyrtuar për të treguar se Bibla nuk është e pagabueshme, por përmban edhe gabime.

Në punimin tim unë zhvillova një arsyetim të gjatë dhe të ndërlikuar, me qëllimin që të tregoja se ndonëse Marku pohon që kjo ngjarje kishte ndodhur “në kohën e kryepriiftit Abiathar”, ai nuk kishte dashur të pohonte këtë, por se ngjarja kishte ndodhur në një pjesë të shkrimit që kishte Abiatharin si personazh kryesor. Argumenti im bazohej në kuptimin e fjalëve në gjuhën greke që ndodheshin në pasazh dhe ishte shumë i ngatërruar. Isha shumë i bindur se profesor Story do ta mirëpriste argumentimin tim, meqënëse unë e dija se ai ishte një i krishterë i mirë dhe një teolog i zoti, i cili, njësoj si unë, kurrë nuk do ta çonte ndërmend se në Bibël mund mund të gjendej ndonjë gabim i mirëfilltë. Por në fund të punimit tim, ai kishte bërë një koment prej vetëm një rrjeshti që më drithëroi të gjithin. Ai kishte shkruar: “Marku ndoshta thjesht ka bërë një gabim.” Unë fillova të vras mendjen për këtë, duke e rishikuar të gjithë punimin tim, duke e kuptuar se më ishte dashur të trilloja plot triblime ekzegjetike për ta zgjidhur problemin dhe se zgjidhja ime ishte, në të vërtetë, disi e sforcuar. Në përfundim, edhe unë thashë: “Hmm...ndoshta Marku ka bërë një gabim këtu.”

Sapo e pranova këtë, digat u hapën. Nëse ekziston një gabim, sado i vogël qoftë ai, tek Marku 2:23-28, atëherë është e mundur, gjithashtu, që të gjenden gabime edhe në vende të tjera. Ndoshta kur Jezusi, më vonë, në ungjillin e Markut, në kapitullin 4, ka thënë për farën e sinapit se “është më e vogla nga të gjitha farërat që janë mbi dhe”, nuk është më nevoja që unë të përdor justifikime fëminore për të shpjeguar se si një farë sinapi mund të jetë fara më e vogël në botë, kur unë e di shumë mirë që nuk është kështu. Ndoshta, këto “gabime”, gjithashtu, mund të gjenden edhe në çështje edhe më të rëndësishme. Ndoshta kur Marku pohon se Jezusi është kryqëzuar një ditë pas ngrënies së darkës së Pashkës (Marku 14:12; 15:25), ndërsa Gjoni pohon se Jezusi vdiq një ditë para se darka e Pashkës të zhvillohej (Gjoni 19:14), ndoshta ky është vërtet një gabim. Ose, kur Luka tregon në rrëfimin e tij të lindjes së Jezusit se Jozefi dhe Maria u kthyen në Nazaret rreth një muaj pasi ata kishin shkuar në Betlehem (dhe kryen aty ritin e pastrimit, Luka 2:39), ndërkohë që Mateu, përkundrazi, pohon se ata u arratisën për në Egjipt (Mateu 2:19-22), ndoshta kjo është, thjesht, një kundërthënie. Ose kur Pali pohon se pas konvertimit të tij rrugës për në Damask nuk ka shkuar në Jeruzalem për të parë ata që ishin apostuj para tij (Galatasve 1:16-17), ndërkohë që në librin e Veprave thuhet se ikja në Jeruzalem ishte gjëja e parë që ai bëri pasi la Damaskun (Veprat 9:26), ndoshta edhe ky është një gabim.

Këto lloj zbulimesh përkuan me problemin që unë hasja sa më shumë që thellohesha në studimin e dorëshkrimeve të mbijetuara të Dhiatës së Re. Thuhet se origjinalet e tekstit biblik kanë qenë të frymëzuara nga Perëndia, por problemi qëndron në faktin se ne nuk i zotërojmë ato. Për këtë arsye, të pohosh se origjinalet janë të frymëzuara nuk sjell asnjë dobi, vetëm nëse jemi të aftë të rindërtojmë tekstin fillestar. Mbi të gjitha, shumica e të krishterëve përgjatë gjithë historisë së

Krishterimit nuk i kanë zotëruar origjinalet, duke e bërë, në këtë mënyrë, teorinë e frymëzimit të tyre një çështje të diskutueshme. Jo vetëm që ne nuk zotërojmë origjinalet, por nuk kemi as kopjet e para të origjinaleve. Ne, madje, nuk zotërojmë as kopjet e kopjeve të origjinaleve, apo kopjet e kopjeve të kopjeve të origjinaleve. Gjithçka kemi janë vetë disa kopje të prodhuara vonë, shumë vonë. Në shumicën e rasteve, janë kopje të bëra *shekuj* më vonë dhe këto kopje ndryshojnë nga njëra-tjetra në mijëra vende. Siç do të shohim më vonë në këtë libër, këto kopje ndryshojnë nga njëra-tjetra në aq shumë vende, sa ne nuk jemi në gjendje të dimë as se sa është numri i ndryshimeve. Ndoshta do të ishte më e lehtë po të bënim një krahasim: ka më shumë dallime ndërmjet dorëshkrimeve biblike që kanë mbijetuar deri më sot sesa ka fjalë krejt Dhiata e Re.

Shumica e tyre, janë të parëndësishme. Një pjesë e mirë e tyre, thjesht na tregojnë se skribët në lashtësi nuk gërmëzonin më mirë se shumica e njerëzve sot (dhe ata nuk kishin as edhe një fjalor, e jo më mundësi për të kontrolluar gërmëzimin). Gjithsesi, si duhet t'u qasemi gjithë këtyre ndryshimeve? Nëse dikush këmbëngul se çdo fjalë e Biblës është e frymëzuar nga Perëndia, ç'duhet thënë atëherë kur kuptojmë se nuk i zotërojmë të gjitha fjalët e shkrimeve? Në shumë raste, siç do ta shohim, ne thjesht nuk mund të jemi të sigurt se kemi rindërtuar saktësisht tekstin origjinal. Është e vështirë të njohim domethënien e fjalëve të Biblës, nëse ne nuk jemi në gjendje të njohim as se cilat janë fjalët e Biblës!

Gjithçka që përmenda u shndërrua në një problem për mua dhe për këndvështrimin tim të frymëzimit të librave biblikë. Kuptova që për Zotin ruajtja e tekstit të shkrimeve nuk mund të ishte më e vështirë sesa frymëzimi i tyre fillestar. Nëse Ai do të dëshironte t'i ruante fjalët e Tij, sigurisht që do t'ia përçonte njerëzve (dhe me shumë gjasa do t'ia përçonte edhe në një gjuhë që ata të mund ta kuptonin, ndryshe nga greqishtja dhe hebraishtja). Fakti që ne nuk zotërojmë fjalët origjinale të tekstit duhet të tregojë, arsyetoja unë, se Ai nuk i ka ruajtur ato për ne. E nëse Ai nuk e ka bërë këtë mrekulli, nuk kishte asnjë arsye përse Ai duhej të kishte kryer mrekullinë tjetër të frymëzimit të këtyre fjalëve.

Shkurtimisht, studimi im i gjuhës greke të Dhiatës së Re, analiza ime e dorëshkrimeve biblike, më çoi në një rishikim rrënjësor të kuptimit të asaj se çfarë ishte Bibla. Ky qe një ndryshim dramatik për mua. Para tij, duke nisur me përvojën time prej të rilinduri, gjatë ditëve të mia prej fundamentalisti në institutin “Moody”, duke vazhduar më tej me ditët e mia prej ungjillori në “Wheaton”, besimi im qe mbështetur krejtësisht në një këndvështrim të veçantë për Biblën që e shihte atë si fjalën e pagabueshme dhe të frymëzuar të Perëndisë. Tani unë nuk e shihja më Biblën në këtë mënyrë. Bibla filloi të më paraqitej thjesht si një libër njerëzor. Ashtu si skribët njerëzorë kishin kopjuar dhe ndryshuar tekstin e shkrimeve, ashtu edhe autorët njerëzorë të këtyre shkrimeve kishin shkruar tekstin e tyre. Ajo ishte një libër njerëzor nga fillimi deri në fund; ishte shkruar nga autorë të ndryshëm në kohë të ndryshme, në vende të ndryshme, për nevoja të ndryshme. Shumë prej tyre, pa dyshim e ndienin veten të frymëzuar nga Zoti për të thënë atë që duhej të thonin, por ata kishin këndvështrimet, besimet, nevojat, dëshirat, konceptimet dhe teologjitë e tyre të veçanta. Këto besime, këndvështrime, nevoja, dëshira, konceptime dhe teologji kanë kushtëzuar gjithçka që ata kanë thënë. Në këtë mënyrë, ata dallojnë shumë prej njeri-tjetrit. Ndër të tjera, kjo do të thotë, se Marku nuk ka thënë të njëjtat gjëra që ka thënë edhe Luka, sepse ai nuk ka pasur të njëjtat koncepte si Luka. Gjoni ndryshon nga Mateu; nuk janë të njëjtë. Pali është i ndryshëm nga çfarë paraqet Libri i Veprave dhe Jakobi ndryshon nga Pali. Secili prej tyre është një autor njerëzor dhe duhet lexuar duke u nisur nga ajo që ai (duke hamendësuar se të gjithë autorët janë meshkuj) ka për të thënë, jo duke marrë si të mirëqenë se çfarë ai ka thënë është e njëjtë, e përputhshme apo e njëtrajtshme me atë që kanë thënë edhe autorët etjerë. Në fund të gjithë kësaj, mund të them se Bibla është thjesht një libër njerëzor.

Ky ishte një këndvështrim krejtësisht i ri për mua e natyrisht i ndryshëm nga besimi im kur isha një i krishterë ungjillor, si dhe i ndryshëm nga shumica e ungjillorëve sot. Më lejoni të sjell një shembull të dallimeve që këndvështrimi im i ri mund të sjellë për kuptimin tim të Biblës. Kur unë studioja në institutin “Moody”, një nga librat më të njohur në kampus ishte projekti i madh apokaliptik i Hal Lindsday-it për të ardhmen, “Planeti madhështor i kohëve të vona: Toka” “*The Late Great Planet Earth*”. Libri i Lindsday-it nuk ishte popullor vetëm në institutin tonë. Ai ishte, në fakt, vepra e patrilluar (*nonfiction*) më e shitur (përveç Biblës, nëse e përdorim disi lirshëm termin “e patrilluar”) në gjuhën angleze në vitet ’70. Lindsday, ashtu si edhe shumica prej nesh në “Moody”, besonte se Bibla ishte absolutisht e pagabueshme në çdo fjalë të saj, aq sa, sipas tij, secili mund ta lexonte Dhiatën e Re e të kuptonte jo vetëm mënyrën se si Perëndia dëshironte që ne të besonim e të jetonim, por edhe planin që Ai kishte për të ardhmen dhe mënyrën se si ai do ta zbatonte atë. Bota ishte në prag të një krize apokaliptike me përmasa katastrofike dhe fjala e pagabueshme e Perëndisë duhej të lexohej për të na treguar si, çfarë dhe kur do të ndodhë kjo. Prej të gjithave, ajo që më tërhoqte më shumë në atë libër asokohe ishte mënyra se si do të ndodhte e gjithë kjo. Lindsday mbështetej te shëmbëlltyra e pemës së fikut për të përcaktuar kohën se kur duhej ta prisnim Armagedonin e ardhshëm. Dishepujt e Jezusit dëshironin të dinin se kur do të vinte fundi. Jezusi iu përgjigj: “*Tani mësoni nga fiku këtë shëmbëlltyrë: kur tashmë degët e tij njomësohen dhe nxjerrin gjethet, ta dini se vera është afër. Kështu edhe ju, kur t’i shihni të gjitha këto gjëra, ta dini se ai është afër, madje te dera. Në të vërtetë po ju them se ky brez nuk do të kalojë, pa u realizuar të gjitha këto.*” (Mateu 24: 32-34)

Cili është kuptimi i kësaj shëmbëlltyre? Lindsday, i bindur se kjo është fjala e pagabueshme e Perëndisë, e zbërthen mesazhin e saj duke pohuar se në Bibël “pema e fikut” shpesh është përdorur si një imazh i kombit të Izraelit. Atëherë si duhet kuptuar shprehja kur tashmë degët e tij njomësohen dhe nxjerrin gjethet? Kjo do të thotë se kombi, pasi të ketë kaluar një periudhë përgjumjeje (dimri), do të kthehet sërish në jetë. Kur u kthye Izraeli në jetë? Më 1948, kur u bë një komb i pavarur. Jezusi, në

shëmbëlltyrë, tregon se fundi do të vijë brenda vetë brezit kur kjo ngjarje ka ndodhur. Sa i gjatë është një brez në Bibël? Dyzetë vjet. Ja, pra, mësimet e frymëzuara të Jezusit: fundi i botës do të ndodhë diku aty rreth viteve 1988, dyzet vjet pas pavarësisë së Izraelit.

Ky mesazh na dukej shumë bindës në atë kohë. Sot mund të duket i tejkaluar, duke pasur parasysh se viti 1988 erdhi dhe iku pa ndodhur Armagedoni, por, nga ana tjetër, ekzistojnë ende miliona të krishterë që *ende* besojnë se Bibla mund të lexohet fjalë për fjalë, si krejtësisht e frymëzuar në parashikimet e saj lidhur me atë që do të ndodhë së shpejti e që do ta dërgojë botën rreth fundit të saj. Dëshmi për këtë është çmenduria e sotme për serinë e Timothy LeHaye-it dhe Philip Jekins-it, e quajtur "*Left Behind*" (Mbetur pas); një tjetër vizion apokaliptik për të ardhmen tonë, mbështetur në leximet e fjalëpërfjalshme të Biblës. Kjo seri, në ditët tona, është shitur në më shumë se *gjashtë milionë kopje*.

Ka një ndryshim rrënjësor midis qasjes ndaj Biblës si plan-projekt i pagabueshëm për besimin, jetën, të ardhmen tonë dhe të shikuarit të saj thjesht si një libër njerëzor, me këndvështrime krejtësisht njerëzore, shumë prej të cilëve ndryshojnë nga njeri-tjeri, e që asnjë prej tyre nuk paraqet një udhëzues të pagabueshëm për mënyrën se si duhet ta zhvillojmë jetën tonë. Ky ishte ndryshimi që unë pata në mendimin tim për Biblën, të cilit, sot e kësaj dite, i qëndroj besnik. Shumë të krishterë, normalisht, nuk kanë mbajtur kurrë një qëndrim literalist ndaj Biblës e për ta, kjo qasje, mund të duket si krejtësisht e njëanshme (për të mos thënë e pazakontë dhe e parëndësishme për çështjet e besimit). Por ekzistojnë, gjithashtu, një mori njerëzish që ende e shohin Biblën në këtë mënyrë. Herë pas here, shoh ndonjë afishe të ngjitur, ku shkruhet: "Zoti e thotë, unë e besoj, dhe puna mbaroi." Përgjigja ime gjithnjë ka qenë: "Po nëse Zoti *nuk* e ka thënë? Po sikur libri që besoni se ju sjell fjalën e Perëndisë të përmbajë vetëm fjalë njerëzore? Po sikur Bibla të mos na ofronjë zgjidhjet përfundimtare për çështje bashkëkohore si aborti, të drejtat e grave, të drejtat e homoseksualëve, çështjet e epërsisë fetare, të demokracisë sipas stilit perëndimor e të tjera të ngjashme? Po sikur ne të jemi të detyruar ta gjejmë vetë mënyrën se si të jetojmë e çfarë të besojmë, pa qenë nevoja ta shndërrojmë Biblën në një idhull të rremë apo në një orakull që hamendësohet se na siguron një linjë të drejtpërdrejtë komunikimi me të Plotfuqishmin? Ekzistojnë, në të vërtetë, arsye bindëse për të menduar se Bibla nuk është një udhëzues i pagabueshëm për jetën tonë: ndër të tjera, siç e kam përmendur, në shumë raste ne (si teologë, ashtu edhe lexues të rregullt) nuk arrijmë dot të njohim as se cilat janë fjalët e Biblës.

Teologjia ime ndryshoi rrënjësisht pasi i kuptova këto gjëra, duke më shtyrë, në këtë mënyrë, në një rrugë krejt tjetër nga ajo që kisha kaluar kur isha adoloshent deri në vitet e para të rinisë sime. Unë vazhdoj ta vlerësoj ende Biblën dhe mesazhet e ndryshme që ajo përmban, ashtu siç u mësova të vlerësoj edhe shkrime të tjera të krishterimit të hershëm, të së njëjtës kohë me shkrimet biblike apo pak më të mëvonshme, të shkruara nga figura më pak të njohura si Ignati i Antiokut, Klementi i Romës dhe Barnabai i Aleksandrisë, siç vlerësoj edhe shkrime të njerëzve që i përkasin feve të tjera, shkrimet e Jozefit, të Lukianit të Samosatës e të Plutarkut. Të gjithë këta autorë janë përpjekur të kuptojnë botën dhe vendin e tyre në të dhe gjithsecili prej tyre ka mësim të vlefshme për të na mësuar. Është e rëndësishme për ne të njohim botën ku ata kanë jetuar, në mënyrë që të kuptojmë se çfarë kanë ata për të na thënë e ç'gjykime kanë për të na dhënë, që më pas ne të vendosim se çfarë duhet të mendojmë dhe si duhet të jetojmë nën dritën e atyre fjalëve.

Kjo më ktheu sërish në pasionin tim për studimin e dorëshkrimeve të Dhiatës së Re, në atë që quhet shkenca e kritikës tekstuale. Jam i bindur se kritika tekstuale është e rëndësishme dhe një fushë studimi intriguese jo vetëm për specialistët, por edhe për këdo që interesohet për Biblën (qoftë ky një

literalist, një literalist i shëruar, dikush që pohon se kurrë në jetë nuk do të jetë literalist, ose çdokush që tregon sadopak interes për Biblën si një dukuri historike dhe kulturore). Ajo që të çudit, gjithsesi, është fakti që shumica e lexuesve, përfshi këtu edhe lexuesin e interesuar për Krishterimin, Biblën, studimet biblike, qofshin këta prej atyre që besojnë në pagabueshmërinë e Biblës apo jo, nuk dinë pothuajse asgjë rreth kritikës tekstuale. Pavarësisht faktit se kjo lëmi e dijes ka qenë pjesë e studimeve biblike këtu e treqind vjet më parë, vështirë se gjendet qoftë edhe një libër i vetëm i kësaj fushe i shkruar për një publik të gjerë, d.m.th. për ata që nuk dinë asgjë rreth kësaj fushe, që nuk e zotërojnë greqishten dhe gjuhët e tjera të nevojshme për një studim të mirëfilltë, që, madje, nuk dinë as të ketë ndonjë “problem” me tekstin biblik, por që do t’i joshte tej mase njohja me këto probleme dhe me mënyrën se si i janë qasur specialistët këtyre vështirësive.²

Ky libër, me sa di unë, është i vetmi libër i këtij lloji. Ai është shkruar për njerëz që nuk dinë asgjë rreth kritikës tekstuale, por që do t’u pëlqente të dinin diçka rreth mënyrës se si skribët e kanë ndryshuar tekstin biblik, si dhe rreth mënyrës se si ne jemi në gjendje ta kuptojmë këtë. Ai është shkruar i mbështetur në studimin tim personal afro tridhjetëvjeçar në këtë fushë, nisur nga këndvështrimi im i tanishëm, i cili është fryt i një ndryshimi rënjesor të mënyrës se si unë e shoh Biblën. Libri është shkruar për këdo që mund të jetë i interesuar të njihet me rrugën se si është përçuar teksti i Dhiatës së Re, se si ne në disa raste nuk jemi në gjendje të njohim formën origjinale të tekstit biblik, mënyrat se si është arritur deri te ndryshimi i tekstit, si dhe mundësinë që, përmes zbatimit të disa parimeve deri diku të rrepta, të jemi në gjendje të rindërtojmë formën fillestare të tekstit. Ky, pra, në shumë mënyra është një libër i veçantë; për mua fundi i një rruge të gjatë. Ndoshta për të tjerët mund të përbëjë pjesë të një udhëtimi të tyre.

Referenca

[1] Miku im Jeff Siker thotë se leximi i Dhiatës së Re në gjuhën greke është një lloj sikur ta shohësh atë më ngjyra, ndërsa leximi i saj nëpërmjet përkthimeve në gjuhët e tjera është sikur ta shohësh bardhezi: arrin ta kuptosh mendimin, por humbet shumë nuanca të tij.

[2] Libri që i afrohet më shumë është ai i David Parker-it, “The Living Text of the Gospels”, The Univ. Press, Cambridge, 1997.

Përktheu: Rezart Beka

Date Created

14/01/2013

Author

erasmusi